51	BANESA PASURI SHTETI (DYQANI I FSHATIT) ne fshatin Vagalat	VAGALAT	LIVADHJA		SARANDË	I	Minist. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
52	BANESA E GARUF KOCINIT ne fshatin Rahulle	RAHULLE	ALIKO		SARANDË	I	Minist. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
53	BANESA E PETRO SHEKES ne fshatin Leshnice e Poshtme	LESHNICE E POSHTME	DHIVER		SARANDË	I	Minist. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
54	KULLA E JANIT (RRENOJAT) ne fshatin Janjar	JANJAR	MARKAT		SARANDË	I	Minist. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
55	BANESA E RUSHIT OMERIT ne fshatin Verve	VERVE	MARKAT		SARANDË	I	Minist. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
56	BANESA E AZBI SHERETIT ne fshatin Dishat	DISHAT	MARKAT		SARANDË	I	Minist. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
57	BANESA E ALUSH MYRTOS ne fshatin Shales	SHALES	MARKAT		SARANDË	I	Minist. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
58	BANESA E SHABAN XHEMILIT ne fshatin Shales	SHALES	MARKAT		SARANDË	I	Minist. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
59	BANESA E BUJAR LAMCES ne fshatin Shales	SHALES	MARKAT		SARANDË	I	Minist. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979

IMPIANT PRODHIMI BETONI
VLORË, SARANDË, SHELEGAR, ZK. 3330, NR. PAS 339/1


60	BANESA E HAME TAKOS ne qytetin e Konispolit			KONISPOL	SARANDË	I	Minist. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
61	BANESA E BEQO ZENUNIT ne qytetin e Konispolit			KONISPOL	SARANDË	I	Minist. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
62	BANESA E VELLEZERVE KOGINI ne qytetin e konispolit			KONISPOL	SARANDË	I	Minist. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
63	BANESA SHTETERORE (ISH BANESA E ALUSH TAKES) ne qytetin e konispolit			KONISPOL	SARANDË	I	Minist. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
64	BANESA SHTETERORE (SPITALI I QYTETIT) ne qytetin e konispolit			KONISPOL	SARANDË	I	Minist. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
65	PORTA E OBORRIT TE BANESES SE HAKI OSMANIT ne qytetin e konispolit			KONISPOL	SARANDË	I	Minist. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
66	BANESA E MAZE GOXHAJT ne qytetin e konispolit			KONISPOL	SARANDË	I	Minist. e Arsimit dhe e Kulturës	2509/1	30.06.1983
67	BANESA (PASURI SHTETI) E DINO OMERIT, Konispol			KONISPOL	SARANDË	I	Minist. e Arsimit dhe e Kulturës	2509/1	30.06.1983
68	BANESA E EQEREM MYRTOS ne fshatin Markat	MARKAT	MARKAT		SARANDË	I	Minist. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
69	BAZILIKA E PESHKËPISË, Nivice, Bubar, Sarande dhe PËRCAKTIMI I ZONËS MBROJTESE	BUBAR	NIVICË		SARANDË	I	M.T.K.R.S. - Drejt. Trasheg. Kombetare	211	18.05.2009
70	ZONA E MBROJTUR E MON."GURORJA ANTIKE NE SHKALLEN E KONISPOLIT", Sarande		XARË		SARANDË		M.T.K.R.S. - Drejt. Trasheg. Kombetare	463	17.11.2009
	ZONA ARKEOLOGJIKE "A"DHE"B" te qytetit te Sarandes dhe miratimi i rregullores se Administrimit				SARANDË		KESHILLI I MINISTRAVE	427 428	20.06.2012
71	KISHA E SHEN E PREMTES		LUKOVE		SARANDË		MINISTRIA E KULTURES	8	08.01.2015

Burimi i Informacionit: Ministria e Kulturës


2. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Në zonën e ushtrimit të këtij aktiviteti, ka burime ujore, të cilat ndodhen jo shumë larg nga objekti, ku do të ushtrohet aktiviteti, të tillë që ndikimet e këtij projekti nuk arrijnë efektet e tyre në këto burime ujore. Burimi ujqor më i afërt me objektin është Lumi i Kalasës, i cili ndodhet rreth 135 m larg në vijë ajrore në perëndim të sipërfaqes. Në këtë zonë identifikohen këto burime ujore: Lumi i Bisticës, i cili ndodhet në Juglindje rreth 2 km larg në vije ajrore dhe Deti Jon, i cili ndodhet mbi 2 km në vijë ajrore në Jugperëndim të sipërfaqes në vlerësim. Sipas informacioneve të paraqitura nga subjekti, ujërat e përdorura nga ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të shkarkohen në mjedisin e zonës, por në vaskën dekantuese, që do të ndërtohet për këtë qëllim.

**Fragment nga studimi urbanistik i Bashkisë Sarandë
Objekti i ri ndodhet në njësinë strukturore SA.UB.12.347**



Pozicionimi në lidhje me burimet ujore



Cilësia e lumenjve

(Bazuar në studimin Kombëtar vjetor të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit)

Monitorimi i cilësisë së ujit është i rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e ujërave, identifikimin e shkaktarëve të ndotjes deri në dhënien e rekomandimeve përkatëse sipas problematikave të identifikuara.

- BASENI I VJOSËS


Lumi Vjosa buron në veriperëndim të Greqisë, në Epir nga malet e Pindit në lindje të Janinës ku rrjedha e tij vazhdon në drejtim të veriperëndimit dhe derdhet në detin Adriatik në Shqipëri.

Lumi ka një gjatësi prej 272 km, prej të cilave 80 km në territorin e Greqisë dhe rreth 192 km brenda territorit të Shqipërisë, rrjedha e të cilit përshkon jugun e Shqipërisë, dhe është kufiri ndarës natyror midis rrethit të Fierit dhe Vlorës.

Oksigjeni i tretur

Vlerat mesatare vjetore të ekspeditave të realizuara janë paraqitur në formë grafike si vijon, ku vlerësojmë se ujërat e këtyre 5 stacioneve të monitoruara janë ujëra të pasura me oksigjen duke i klasifikuar këto ujëra në Klasën I – Gjendje e lartë


OKSIGJENI I TRETUR



Nevoja Biokimike për oksigjen

Ky parametër është i rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumenjve si një tregues i shkallës së ndotjes, i cili për të gjithë stacionet është brenda vlerës limite të lejuar ku spikat Vj2 – Ura e qytetit me një vlerë mesatare 3 mg O/l duke e klasifikuar në Klasën II – Gjendje e mirë këtë stacion ku impakt kanë shkarkimet urbane të zonave të banuara.


NEVOJA BIOKIMIKE PER OKSIGJEN



Përmbajtja e amoniakut

Përcaktimi i përmbajtjes së amoniakut në kampione uji i përcaktuar me metodën spektrometrike është parametër kryesor i klasifikimit në klasa të cilësisë së ujërave sipas DKU. Grafiku paraqet të dhënat mesatare vjetore nga ku vlerësojmë se ujërat e këtyre stacioneve për përmbajtjen e amonjakut janë të një cilësie shumë të mirë duke u klasifikuar në Klasën I – Gjendje e lartë, të cilat variojnë nga 0.018 mg/l – 0.034 mg/l (norma < 0.05 Klasa I).

PERMBAJTJA E AMONJAKUT




Përmbajtja e nitriteve

Përmbajtja e nitriteve në stacionet e monitorimit të Basenit të Vjosës është në limitin e dedektimit në vlerat 0.001 mg/l duke i klasifikuar në Klasën I – Gjendje e lartë.

Përmbajtja e nitrateve

Përmbajtja e nitrateve në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera më të ulëta se norma e lejuar duke i klasifikuar në Klasën I – Gjendje e lartë të gjitha stacionet e monitoruara.


PERMBAJTJA E NITRATEVE



Përmbajtja e fosforit

Referuar të dhënave mesatare, vlerësojmë se nuk kemi tejkallim të vlerës limite të përmbajtjes së orto – fosfateve duke i klasifikuar këto stacione në Klasën I – Gjendje e lartë, përse i përket përmbajtjes së fosforit.


PERMBAJTJA E FOSFORIT



Përmbajtja e fosforit total

Referuar vlerave mesatare të dy ekspeditave të realizuara gjatë periudhës Shkurt – Qershor 2018 vlerësojmë se stacionet nuk e tejkalojnë vlerën e lejuar, përmbajtja e të cilave varion nga 0.048 mg/l – 0.059 mg/l duke i klasifikuar në Klasën I- Gjendjen e lartë. (<0.1 mgP/l).

PERMBAJTJA E FOSFORIT TOTAL



Duke marrë në konsideratë të gjithë parametrat e DKU, vlerësojmë se stacionet e Basenit të Vjosës klasifikohen si ujëra me cilësi të mire, të cilat renditen në Klasën II – Gjendje e mire.

Burimi i informacionit: Raporti i gjendjes së mjedisit për vitin 2018, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombetare e Mjedisit (Faqa Zyrtare).

3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

3.1 INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR

Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor për VNM-në dhe ka për qëllim që të parashikojë, identifikojë, vlerësojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit të propozuar.

Proçedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) proçesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) proçesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Objektivat afatshkurtër të VNM-së janë:

- Përmirësim nga pikëpamja mjedisore të projektit të propozuar;
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrën e duhur dhe me efikasitet;
- Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit;
- Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të Disponueshme të teknologjisë së propozuar për t'u aplikuar;
- Identifikon masat e duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit të propozuar;
- Mundëson informimin e vendim-marrësve, duke gjykuar në miratimin ose jo të projektit dhe kushteve që duhet të vendosen në aktin e miratimit;

Objektivat afatgjatë të VNM-së janë:

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/dëmtimet e pakthyeshme të mjedisit;
- Ndikon në mbrojtjen e burimeve natyrore, peizazhet e natyrës dhe komponentët përbërës të ekosistemeve;
- Përmirëson aspektet sociale-ekonomike të projektit;
- Ndhmon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

Përshkrim i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin Legjislati i mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe dëmtimin e komponentëve të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit nga faktorë të ndryshëm, njerëzorë dhe natyrorë. Ndër ligjet më kryesore në lidhje me këtë projekt, mund të përmendim:


- **Ligji Nr 10431 datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.**
- **Ligji Nr 10440 datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.**
- **Ligji Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440, datë 7.7.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.**
- **Ligji Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.**
- **Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.**
- **Ligji Nr.10266 për disa ndryshime në ligjin 8897 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.**
- **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.**
- **Ligji Nr. 68/2014 për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9587, datë 20.07.2006.**
- **Ligji Nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”.**
- **Ligji Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.**
- **Ligji Nr. 124/2015 datë 12.11.2015 “Për efikasitetin e energjisë”.**
- **Vendim i KM Nr. 313, datë. 09.05.2012 “Për rregulloren e mbrojtjes së publikut nga shkarkimet në mjedis”.**
- **Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 “Per menaxhimin e zhurmave”.**
- **Vendim i KM Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore”.**
- **Vendim i KM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.**
- **Vendim i KM Nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”.**
- **Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse”.**
- **Vendim i KM Nr. 99, date 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut Shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”.**
- **Udhëzim Nr. 8, datë.27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave”.**


3.2 PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

Kjo përmbledhje joteknike e raportit paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, hartohet me kërkesë të subjektit "ALIKO NDËRTIMI 2" Sh.p.k, me numër NIPT-i: L92803602A, me seli në Gjirokastrë, pranë rrugës Nacionale "Gjirokastrë-Kakavijë". Tek kthesa e Kordhocës, godinë 2-katëshe, nr. Pasurie 2/24, zona kadastrale 2392 dhe përfaqësues ligjor Z. Drini Aliko. Ky subjekt është në përgatitje të procedurës për konsultimin me publikun dhe do të aplikojë pranë QKB-AKM për pajisje me Leje Mjedisit tipi B për aktivitetin prodhim betoni. Objekti i vlerësimit të kësaj përmbledhjeje është aktiviteti i prodhimit të betonit. Ky aktivitet do të ushtrohet në Qarkun Vlorë, Bashkia Sarandë, fshati Shelegar, Zona Kadastrale nr. 3330, pronë me numër pasurie 339/1. Sipërfaqja e pronës ku do të zhvillohet aktiviteti është $S=3840 \text{ m}^2$. Prona, e cila do të përdoret në funksion të këtij aktiviteti është e llojit arë, konkretisht: prona me Nr. Pasurie 399/1, zona kadastrale 3330, volumi 3, faqe 41, arë, me sipërfaqe totale 3840 m^2 , e ndodhur në Shelegar, në pronësi të shoqërisë "ALIKO NDËRTIMI 2" SHPK, sipas çertifikatës për vërtetim pronësie të lëshuar nga ZVRPP Sarandë. Aktualisht në këtë prona janë kryer disa punime ndërtimore paraprake në funksion të impiantit të prodhimit të betonit, sipërfaqja e pronës po rrethohet me mur rrethues me blloqe betoni, si dhe një pjesë e saj po shtrohet me beton. Kjo përmbledhje joteknike e raportit të Vlerësimit të ndikimit në mjedis parshikon ndikimet në mjedis që mund të shkaktojë aktiviteti i prodhimit të betonit, që përdoret si lëndë e pare për ndërtim (ndërtim objekteve, mure rrethuese, rrugë, etj).


Sqarim: Bazuar në shtojcat I dhe II të ligjit nr. 10440, date 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", ky aktivitet nuk përfshihet në listën e aktiviteteve, të cilat duhet t'i nënshtrohen procedurës paraprake ose të thëlluar të Vlerësimit të ndikimit në Mjedis, si rrjedhojë ky aktivitet mund të aplikojë vetëm për pajisjen me leje mjedisore të tipit B sipas shtojcës nr. 1 të ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 "Për lejet e Mjedisit", i ndryshuar. Kjo përmbledhje joteknike e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis hartohet për të informuar publikun dhe institucionet e mbrojtjes së mjedisit mbi ndikimet në mjedis të aktivitetit.

Ortofoto të vendodhjes së sipërfaqes në vlerësim





Harta topografike e rajonit. Nomenklatura e Hartës në shkallë 1:2500 (J-34-5-(82-C)



Koordinatat në sistemin Gaus-Krüge të gjeneruar në portalin asig.gov.al		
Nr.	Koordinatat Lindje Y	Koordinatat Veri X
1	4417407.16	4417210.8
2	4417524.55	4417152.92
3	4417496.48	4417134.75
4	4417398.91	4417174.76

Koordinatat në sistemin KRGJSH të gjeneruar në portalin asig.gov.al		
Nr.	Koordinatat Veri N	Koordinatat Lindje E
1	4416633.68	502815.47
2	4416577.12	502933.49
3	4416558.64	502905.63
4	4416597.56	502807.63

Foto të sipërfaqes ku do të ushtrohet aktiviteti





Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)

Vlerësimi i ndikimeve në mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes së mjedisit, të cilat janë:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vlerësim kryhet në bazë të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", i ndryshuar dhe në përputhje me kërkesat e VKM-së Nr. 686, datë 29.07.2015 "Për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis" dhe ka si synim identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e ndotjes së mjedisit, me qëllim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera;
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

Ndikime të rëndësishme gjatë funksionimit të aktivitetit.

Shkarkime në ujë

Ujërat që dalin nga aktiviteti do të jenë ujëra, të cilat lindin si rrjedhojë e aktivitetit të prodhimit të betonit dhe të larjes ose shpëlarjes së kantierit nga rreshjet atmosferike. Këto ujëra janë ujëra të turbullt, me përbërje të fraksioneve të imëta të tokës/inerteve, të tilla si rëra dhe mund të kenë edhe një përqindje të vogël çimentoje të tretur. Këto fraksione të imëta të materialit tokësor duke qënë të përmasave tepër të imëta, treten lehtësisht në ujë dhe dekantimi/sedimentimi i tyre bëhet më i vështirë e kërkon kohë më të gjatë. Këto ujëra nëse shkarkohen në mjedisin ujor pritës, kanë sado pak ndikimin e tyre në dëmtimin e burimeve ujore pritëse dhe si rrjedhojë edhe faunën e florën ujore. Efekti i tyre shkakton humbjen e dritës diellore nën ujë, ul qartësinë dhe transparencën e ujit, duke vështirësuar apo bërë të pa mundur të ushqyerit e gjallesave. Për këtë qëllim, subjektit i rekomandojmë ndërtimin e disa vaskave dekantuese, ku uji të ketë mundësi të kalojë një gjendje qetësie e grimcat e imëta të dekantohen në fund, duke ulur lëndën në pezulli. Sipas gjendjes aktuale të këtij impianti, ujërat e përdorura kalojnë në një vaskë dekantuese nga ku dekanton faza më e trashë e turbullirës. Pas dekantimit këto ujëra tërhiqen me pompë për t'u ripërdorur në procesin e prodhimit të betonit. Në sheshin e aktivitetit, nuk magazinohen materiale të rrezikshme dhe si rrjedhojë nuk ka ndotje të ujërave nëntokësore ose sipërfaqësore nga kimikate të rrezikshme. Sheshi, në të cilin do të instalohet impianti do të shtrohet me beton.

Emetimet në ajër

Emetimet në ajër nga ky instalim mund të vijnë vetëm nga pluhuri i rërës nga lënda e parë e magazinuar, i cili mund të ngrihet nga faktorët klimatike. Gjithashtu, procesi i prodhimit do të shoqërohet me çlirim zhurme, por nuk vlerësohet në nivele të larta e shqetësuese për zonën (për këtë subjekti duhet të kryejë një testim nga laboratorë të akredituar).

Shkarkimet spontane, nuk vlerësohen me ndikime të rëndësishme në mjedis dhe në komunitetin e zonës. Përveç pluhurit të ngritur në ajër nga era, në këtë ambient, mund të vlerësohen edhe gazet që shkarkohen nga makineritë e ngarkim-shkarkimit dhe nga transportuesit e materialit.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat që do të prodhohen vijnë kryesisht nga makineria e prodhimit të betonit. Procesi i prodhimit shoqërohet me çlirim zhurme, por nuk vlerësohet në nivele të larta e shqetësuese për zonën (për këtë subjekti duhet të kryejë një testim nga laboratorë të akredituar).

Ndikimi në tokë

Proceset e punës do të ndikojnë në tokë për shkak të depërtimit të ujërave të kantierit në ujërat nëntokësore, gjithashtu zënia e një sipërfaqe toke nga instalimi dhe magazinimi i materialeve inerte, është tashmë një fakt dhe nuk ndryshon asgjë vlerësimi në këtë fazë.

Ndikimi në Biodiversitet

Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura me ligj, sipas verifikimit të kryer në portalin gjeohapësinor shtetëror asig.gov.al. Aktiviteti ndodhet në një zonë larg zonave të banuara. Ky aktivitet nuk ndikon në dëmtimin e biodiversitetit të zonës.

Ndikimi ne Mjedisin Social

Ndikimi i këtij aktiviteti në mjedisin social është pozitiv, përse i përketë punësimit, shërbimit të shitjes së betonit, i cili përdoret si lëndë e parë në ndërtim.

Mbetjet e prodhuara

Mbetje të ngurta nuk prodhohen. Mbetje të tjera mund të vlerësohen ato urbane nga aktiviteti human. Nuk vlerësohet aktivitet me mbetje të ngurta, pasi materiali është 100 % i përdorshëm, për të gjitha fraksionet. Llumi i vaskës dekantuese ripërdoret në procesin e prodhimit, ose në aktivitete ndërtimore, shtrim rrugësh etj, sipas nevojave të zonës.

Mbetjet e ngurta që prodhohen në këtë aktivitet janë:

- Mbetjet e llumrave të vaskës dekantuese të ujërave të përdorura.
- Mbetjet e ngurta urbane nga aktiviteti human të tilla si Plastmas, Plasike HDPE, Karton, Letër, Qelq, Metale.

Mbetjet e ngurta urbane që do të prodhohen nga aktiviteti human, janë shënuar si më poshtë me kodet përkatëse bazuar në Vendimin Nr. 99, datë 18.02.2005 "Për Miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve":

Letër dhe karton	20 01 01
Qelq	20 01 02
Plastikët	20 01 39
Metalet	20 01 40

4. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.

Informacion për shkarkimet në mjedis

Shkarkime në ujë

Ujërat që dalin nga aktiviteti do të jenë ujëra, të cilat lindin si rrjedhojë e aktivitetit të prodhimit të betonit dhe të larjes ose shpëlarjes së kantierit nga rreshjet atmosferike. Këto ujëra janë ujëra të turbullt, me përbërje të fraksioneve të imëta të tokës/inerteve, të tilla si rëra dhe mund të kenë edhe një përqindje të vogël çimentoje të tretur. Këto fraksione të imëta të materialit tokësor duke qënë të përmasave tepër të imëta, treten lehtësisht në ujë dhe dekantimi/sedimentimi i tyre bëhet më i vështirë e kërkon kohë më të gjatë. Këto ujëra nëse shkarkohen në mjedisin ujqor pritës, kanë sado pak ndikimin e tyre në dëmtimin e burimeve ujore pritëse dhe si rrjedhojë edhe faunën e florën ujore.

Shkarkimet në ajër

Emetimet në ajër nga ky instalim mund të vijnë vetëm nga pluhuri i rërës nga lënda e parë e magazinuar, i cili mund të ngrihet nga faktorët klimatike. Gjithashtu, procesi i prodhimit do të shoqërohet me çlirim zhurme, por nuk vlerësohet në nivele të larta e shqetësuese për zonën (për këtë subjekti duhet të kryejë një testim nga laboratorë të akredituar).

Shkarkimet spontane, nuk vlerësohen me ndikime të rëndësishme në mjedis dhe në komunitetin e zonës. Përveç pluhurit të ngritur në ajër nga era, në këtë ambient, mund të vlerësohen edhe gazet që shkarkohen nga makineritë e ngarkim-shkarkimit dhe nga transportuesit e materialit.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat që do të prodhohen vijnë kryesisht nga makineria e prodhimit të betonit. Procesi i prodhimit shoqërohet me çlirim zhurme, por nuk vlerësohet në nivele të larta e shqetësuese për zonën (për këtë subjekti duhet të kryejë një testim nga laboratorë të akredituar).

Mbetjet e prodhuara

Mbetje të ngurta nuk prodhohen. Mbetje të tjera mund të vlerësohen ato urbane nga aktiviteti human. Nuk vlerësohet aktivitet me mbetje të ngurta, pasi materiali është 100 % i përdorshëm, për të gjitha fraksionet. Llumi i vaskës dekantuese ripërdoret në procesin e prodhimit, ose në aktivitete ndërtimore, shtrim rrugësh etj, sipas nevojave të zonës.

Mbetjet e ngurta që prodhohen në këtë aktivitet janë:

- Mbetjet e llumrave të vask Ndikimi i aktivitetit në kushte normale funksionimi zgjat për aq kohë sa zgjat edhe aktiviteti prodhues, pra pak ore në ditë dhe sasi të vogla shkarkimesh. Ndikimi në mjedis zgjat për aq ore sa funksionon aktiviteti në ditë dhe aq ditë sa ai funksionon në një vit.

s dekantuese të ujërave të përdorura.

- Mbetjet e ngurta urbane nga aktiviteti human të tilla si Plastmas, Plasike HDPE, Karton, Letër, Qelq, Metale.

5. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.

Ndikimi i aktivitetit në kushte normale funksionimi zgjat për aq kohë sa zgjat edhe aktiviteti prodhues, pra pak orë në ditë dhe sasi të vogla shkarkimesh. Ndikimi në mjedis zgjat për aq orë sa funksionon aktiviteti në ditë dhe aq ditë sa ai funksionon në një vit.

6. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS.

Ndikimi në mjedisin e zonës në kushte normale të punës, mund të përhapet në një distancë fare të ngushtë, me dhjetëra metra, kjo përse i përketë ndikimit të zhurmës, pasi ndikimi në ujëra nëse do të shkarkohen në mjediset ujore mbi vlerat e lejuara, do të shtrinte ndikimin e tij deri në burimin ujor pritës. Ujërat e gjeneruar nga aktiviteti nuk kanë ndotje kimike, por vetëm turbullirën me lëndën e fraksioneve të imëta të materialeve inerte. Nuk shkarkohen substanca ose elemente të dëmshme për mjedisin, si në atë ujor, për ajrin, tokën dhe për biodiversitetin.

7. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.

Subjekti investitor duhet të kujdeset për një mjedis të pastër, të rregullt, të gjelbëruar, të sigurtë dhe të pajisur me sinjalistikën dhe posterat sensibilizues përkatës për kushtet teknike dhe për mjedisin. Mjedisi i këtij aktiviteti është me funksion si kantier prodhim betoni. Në rast të mbylljes së aktivitetit merret në konsideratë mundësia e rehabilitimit të plotë të sipërfaqeve dhe kthimin e peizazhit në gjendjen e mëparshme. Subjekti duhet që gjatë zhvillimit të aktivitetit të tij, të kryejë edhe punime për ruajtjen e mjedisit, të tilla si mbjellje pemësh në të gjithë perimetrin e pronës.

8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

Në mënyrë të përgjithshme paraqesim disa prej masave që duhet të zbatohen nga investitori për mbarëfunksionimin e aktivitetit dhe ruajtjen e mjedisit.

- Duhet të punohet sipas rregullores së kushteve teknike, nuk duhet të lejohen derdhje të karburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse në mjedisin e aktivitetit, pasi ndotin ambientin dhe mund të jenë burim aksidenti e shkaktar të zjarreve të pa dëshiruara e më tej mund të shkaktojë edhe shpërthime.
- Në sheshin e aktivitetit, nuk duhet të magazinohen materiale të rrezikshme.
- Të mirëmbahet vaska dekantuese e ujërave të përdorura.
- Të ndërtohet edhe një ose dy vaska dekantuese për ujërat e sheshit të prodhimit të betonit.
- Mjetet rrugore që qarkullojnë duhet të jenë konform normave të përcaktuara dhe të testuara nga Qendra e Kontrollit Teknik të automjeteve e të pajisura me çertifikatën përkatëse.
- Të mirëmbahet sheshi i depozitimit, duke mos lejuar erozionin dhe shplarjen e materialit për në burimin ujqor pritës.
- Punëtorët që do të ndodhen në mjedisë ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin duhet të përdorin masa mbrojtëse për shqisat e dëgjimit (Kufje ose tapa për veshët).
- Të rehabilitohet sipërfaqja përreth objektit, duke u gjelbëruar dhe duke krijuar një efekt ndihmës në reduktimin e zhurmës dhe të pluhurit.
- Subjekti të mos shfrytëzojë burimet ujore apo ato tokësore të zonës pa miratimin e autoriteteve përkatëse më parë.
- Të respektohen normat në fuqi të shkarkimeve në mjedis sipas VKM-së Nr. 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
- Të mbillen pemë të larta (dru pyjqor) në të gjithë perimetrin e pronës, me qëllim reduktimin e ndikimit në peizazhin e zonës.
- Të mos punohet gjatë orëve të vona.

9. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).

Ky aktivitet nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëmtim të mjedisit ndërkufitar. Projekti nuk ndikon në cënimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit as të shteteve fqinje, as të qendrave të banuara të rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore ndërkufitare, nuk ndikohet cilësia e ajrit në kontekstin ndërkufitar. Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtetet fqinje.